

KOMUNA E MALISHEVËS BULETINI

Nr. 114- Dhjetor 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



*Pamje nga ceremonia e dhënies së çmimit
“Dr. Tafil Kelmendi”
veprimtarit Adem Demaçi*



Përmbajtja:

Adem Demaçi nderohet me çmimin “Dr.Tafil Kelmendi”	2
HANDIKOS-i në Malishevë ka shënuar 10 vjetorin e punës.....	3
Komuna e Malishevës dhe CDF-ja do të riparojnë shkollën në Bellanicë.....	4
KK miratoi propozimin e Kryetarit për emërtimin e rrugëve.....	5
Rrugët e hapura, por vështirë të kalueshme	5
HANDIKOS- i falënderon Kryetarin Kilaj për mbështetje	6
KPF-ja dha tri rekomandime për Asamble	7
Asgjësohen 142 krere dele të sëmura nga “bruceloza”	8
Komuna do ti ndihmoj familjet të cilat janë me asistencë sociale për festat e fundvitit	9
Komuna dhe Caritas Kosova investojnë në shëndetësinë e Malishevës	9
Inspektorët në aksion për mallra me afat të skaduar.....	10
Kryetari Kilaj, mbajti takimin e dytë publik me qytetarë	11
Asambleja vendosi që veteranët e luftës të lirohen nga taksat	12

Adem Demaçi nderohet me çmimin “Dr.Tafil Kelmendi”

Malishevë, 3 dhjetor

Shoqata për Kulturë dhe Letërsi “Dr.Tafil Kelmendi”, ka nderuara sot me çmimin tradicional



“Dr.Tafil Kelmendi”, veprimtarin Adem Demaçi, për kontributin e dhënë në fushën e kulturës, veçmas në krijimtarinë letrare. Çmimin “Dr.Tafil Kelmendi” veprimtarit Adem Demaçi, ja dorëzoi Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj.

Ceremonia e ndarjes së këtij çmimit, filloi me antonimin e himnit kombëtar, për të vazhduar me leximin e një tregimi nga Adem Demaçi, nga ana e klubit letrarë të gjimnazit “Hamdi Berisha”.

“Ndihe mi krenar që sot, në mesin tonë, kemi njeriun e madh, simbolin e rezistencës kombëtare, njeriun me të cilin janë rritur e edukuar breza të tërë, Adem Demaçin”, tha në fjalën e tij kryesuesi i Asamblesë Komunale të Malishevës, z.Ragip Begaj.

“Faleminderit për nderin që më keni bërë”, tha Adem Demaçi, pasi ju dha edhe zyrtarisht ky çmim, nga ana e Kryetarit të Malishevës. “Jemi në 100 vjetorin e Pavarësisë dhe detyrimisht, më duhet ti them disa fjalë, për rrugëtimin e popullit shqiptar, deri në shpalljen e Pavarësisë”, tha Demaçi, i cili në mënyrë kronologjike, paraqiti rrugëtimin e popullit shqiptar, deri më 28 Nëntor 1912.

“Pavarësia u shpall, por populli shqiptar mbeti i ndarë në gjashtë pjesë, pasi kjo ndarje ishte strategji e armiqve tanë. Ne sot jetojmë më mirë, por jepi prapë të ndarë, jo për fajin tonë dhe synim i yni mbetet të jetojmë të bashkuar”, tha Demaçi. “Të gjithë popujt luftojmë për tu bashkuar, por rrethanat dhe realitetet e reja, na bëjnë që ne të luftojmë të bashkohemi në Evropë. Evropa e bashkuar, është njëra prej formave të bashkimit, brenda kulmit të Bashkimit Evropian”, tha mes tjerash në fjalimin e tij, z.Adem Demaçi.

HANDIKOS-i në Malishevë ka shënuar 10 vjetorin e punës

Malishevë, 3 dhjetor

Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi (QRBB)- HANDIKOS, në Malishevë, ka shënuar dhjetë vjetorin e punës së vet, në përkujdesje ndaj personave me aftësi të kufizuara. HANDIKOS në Malishevë, është themeluar me 3 dhjetor të vitit 2002.

Në ceremoninë e mbajtur me rastin e 10 vjetorit të punës, koordinatorja e kësaj qendre, Feride Hoxha, ka theksuar se “kjo periudhë dhjetëvjeçare e punës ka qenë e përshkruar me sfida nga më të ndryshmet”.

Kjo qendër, e ka nisur punën e saj me 3 dhjetor të vitit 2002, vit kur edhe është ndërtuar objekt i kësaj qendre rehabilituese, objekt i cili ofron kushte solide për punë, me personat me aftësi të kufizuara.

Kjo qendër rehabilituese, numëron rreth 700 anëtar, të cilëve ju ofron shërbime të ndryshme të përkujdesjes.

Truallin për ndërtimin e objektit, e ka ndarë Kuvendi i Komunës së Malishevës, ndërsa në vazhdimësi, e ka përkrahur edhe financiarisht këtë qendër.

Komuna e Malishevës dhe CDF-ja do të riparojnë shkollën në Bellanicë

Malishevë, 7 dhjetor



Community Development Fund (CDF), Komuna e Malishevës dhe përfaqësuesi i fshatit Bellanicë, sot kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi, për zbatimin e projektit për rehabilitimin e Shkollës Filllore dhe e Mesme e Ulët, “Ismail Qemali”, në Bellanicë.

Sipas marrëveshjes, të cilën e ka nënshkruar drejtoresha ekzekutive e CDF-it, znj. Nermin Mahmuti, Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe kryesuesi i komisionit të projektit, z. Sefer Hoxhaj, CDF-ja do të financoj rreth 52 përqind të projektit, ndërsa Komuna e Malishevës, do të financoj 48 përqind të projektit.

Sipas këtij projekti, do të bëhet riparimi komplet i Shkollës Filllore dhe e Mesme e Ulët “Ismail Qemali”, në fshatin Bellanicë, ku përfshihet riparimi i brendshëm dhe i jashtëm i objektit të shkollës.

KK miratoi propozimin e Kryetarit për emërtimin e rrugëve

Malishevë, 7 dhjetor



Asambleja Komunale e Malishevës, në mbledhjen e saj të njëmbëdhjetë për këtë vit, ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesën e Kryetarit të Komunës nr. 01/995 të datës 14.11.2012, për miratimin e propozim-emërtimit të rrugëve dhe rrugicave të qytezës dhe fshatrave të Komunës së Malishevës.

Me shumicë të votave, dhe me propozime për plotësimin për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave, kjo kërkesë e Kryetarit të Komunës, ka marrë pëlqimin e 17

këshilltarëve komunal, ndërsa 12 këshilltar, kanë abstenuar.

Në fillim të mbledhjes së radhës së Asamblesë Komunale, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, z.Enver Hoti, ka reaguar për arrestimet e deputetit të Kuvendit të Kosovës, z.Fatmir Limaj, Naser Krasniqit, Naser Shalës dhe Nexhmi Krasniqit, lidhur me rastin “Kleçka”. “Shprehim indinjatën e thellë për këto arrestime”, tha Hoti, duke i cilësuar këto arrestime dhe rihapjen e rastit “Kleçka” “me prapavijë”.

Rrugët e hapura, por vështirë të kalueshme

Malishevë, 10 dhjetor



Të gjitha rrugët në Komunën e Malishevës, janë të hapura, por me vështirësi të kalueshme, për shkak të ngricave, sidomos në rrugët e fshatrave, përderisa më me vështirësi kalohen rrugët në fshatrat e Maleve të Berishës, kanë të ditur sot Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Policia e Kosovës.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, z.Alban Kastrati, kompania për mirëmbajtjen e rrugëve, “Ekoregjioni”, njësia në Malishevë, pritet që gjatë ditës së

sotme, të filloj me hedhjen e kripës dhe rërës në rrugët me ngrica, ndërsa gjatë ditës së djeshme kanë qenë në teren për hapjen e rrugëve nga bora.

Edhe rrugët brenda qytetit, në orët e paradites, janë të mbuluara me akull, përderisa edhe magjistrale dhe rrugët ndërkomunale, Orllat-Rahovec dhe ajo Duhël-Kijevë, janë me ngrica.

Sipas komandantit të Stacionit Policor në Malishevë, Bekim Begaj, të gjitha rrugët janë të hapura, por vështirë të kalueshme, si pasojë e ngricave në rrugë. “Gjatë dy ditëve të fundit, është shënuar vetëm një aksident në rrugë, si pasojë e ngricave, por për fat të mirë pa pasoja”, ka thënë Begaj, duke ju bërë thirrje vozitësve, për kujdes të shtuar dhe respektim të shenjave në komunikacion, si dhe për mbajtjen e pajisjeve dimërore në vetura.

HANDIKOS- i falënderon Kryetarin Kilaj për mbështetje

Malishevë, 10 dhjetor

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, është falënderuar zyrtarisht nga Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi (QRBB) -HANDIKOS në Malishevë, për mbështetjen që kryetari Kilaj, i ka dhënë në vazhdimësi kësaj qendre. Mirënjohjen falënderuese, kryetarit Kilaj, ja dha sot, koordinatorja e kësaj qendre rehabilituese në Malishevë, znj.Feride Hoxha.



“Ky falënderim, është për ju kryetar, për ndihmën e vazhdueshme, tash e dhjetë vite, që jep Komuna e Malishevës dhe ju personalisht, e si rezultat i kësaj, HANDIKOS-i në Malishevë, funksionon dhe ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara”, ka thënë znj. Hoxha, duke e falënderuar kryetarin Kilaj.

Në anën tjetër, kryetari Kilaj, tha se “edhe personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë sonë dhe janë të barabartë me të gjithë të tjerët dhe si të

tillë, duhet të trajtohen të barabartë”.

Paraprakisht, kryetari Kilaj, ka premtuar vazhdimin e ndihmës për këtë qendër rehabilituese edhe në vitin 2013, ashtu siç është përkrahur deri më tani.

Përveç sigurimit të transportit për personat me aftësi të kufizuara, Komuna e Malishevës, ka mbështetur edhe shkollimin e këtyre personave, si në klasat e përbashkëta, ashtu edhe në vazhdimin e studimeve universitare.

KPF-ja dha tri rekomandime për Asamble

Malishevë , 20 dhjetor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) organ i Asamblesë Komunale të Malishevës, në mbledhjen e saj të njëzet të radhës, e udhëhequr nga kryesuesi z.Ragip Begaj, dha tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), me shumicë të votave, e kanë aprovuar dhe e kanë rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në Asamble, Projekt Rregulloren, për ngarkesa, tarifa dhe gjoba komunale, për vitin 2013.

Po ashtu KPF-ja ka shqyrtuar dhe rekomanduar për Kuvend edhe kërkesat e grupit të këshilltarëve të LDK-së, të cilat kanë të bëjnë me arsimin në komunën tonë: Raporti i drejtorit

të DKA-së, për përfundimin e vitit shkollor 2011/12 dhe Raporti i drejtorit të DKA-së, për fillimin e vitit shkollor 2012/13.

Asgjësohen 142 krere dele të sëmura nga “bruceloza”

Malishevë, 21 dhjetor

Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës (AUV), në bahskëpunim me Drejtorinë e Inspektoratit në



Malishevë, kanë asgjësuar 142 krerë dele, në fshatin Lubizhdë, pasi paraprakisht këto dele kanë rezultuar pozitiv në sëmundjen e Brucella Melitensis, apo siç njihet me emrin “Bruceloza”.

Sipas drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit, z.Ismet Kafexholli, “Asgjesimi është bërë nga ana e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës (AUV-së), nënë mbykqyrjen e inspektorit të veterinës të AUV-së dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoratit-Inspektoret Komunal të shoqëruar edhe nga Policia e Kosovës , ku aksioni është kryer pa ndonjë problem”.

“Me datë 30.05.2012, po këti fermeri i janë asgjësuar edhe 88 krerë dele të cilat edhe ato kanë qenë të prekura nga po kjo sëmundje dhe si pasojë e rishfaqjes së serishme të kësaj sëmundje , agjensioni në fjalë ka marrë vendim që të bëhet asgjësimi i të gjitha deleve me qëllim që të eliminohet infeksioni në këtë fermë dhe të mos përhapet si sëmundje infektive në kafshë dhe njerëz në teritorin tonë”, thuhet në njoftimin e Drejtorisë së Inspektoratit.

Pas largimit të të gjitha deleve nga shtalla ka filluar të bëhet edhe desinfektimi i shtallës, mjeteve të punës dhe hapsirës përreth.

Kompenzimin e fermerit për delet e asgjësuar do i bartë AUV-së.

Nga mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve

Komuna do ti ndihmoj familjet të cilat janë me asistencë sociale për festat e fundvitit

Malishevë, 24 dhjetor



Qeveria e Komunale e Malishevës, do të vazhdoj me traditën e saj për të ndihmuar familjet e dëshmorëve dhe familjet në asistencë sociale, për festat e fundvitit. Këtë e bëri të ditur Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e rregullt të së hënës të Qeverisë Komunale, ku u diskutua edhe për çështje të tjera të punës së drejtorive komunale në përfundim të këtij viti kalendarik.

“Do të ndihmohen të gjitha familjet e dëshmorëve dhe të gjitha familjet në asistencë sociale, në prag të festave të fundvitit, me nga një pako ushqimore”, njoftoi kryetari Kilaj.

Në këtë mbledhje e diskutua edhe për çështje të tjera të punës së drejtorive komunale. Drejtori për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, njoftoi se drejtoria ka hartuar projekt rregulloren për ngarkesa, taksa dhe gjoba komunale, e cila do të shqyrtohet dhe pritet të miratohet në mbledhjen e Asamblesë Komunale, gjatë kësaj jave.

Komuna dhe Caritas Kosova investojnë në shëndetësinë e Malishevës

Malishevë, 24 dhjetor

Komuna e Malishevës dhe Caritas Kosova, ditë më parë, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me qëllim të realizimit të projektit të përbashkët “Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatorë në Malishevë”, me qëllim të përmirësimit të shërbimit shëndetësor në zonat rurale dhe rritjes së nivelit të kujdesit shëndetësor.

Marrëveshja e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit, është nënshkruar në mes të Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe Don Viktor Sopit, drejtor gjeneral për Caritas Kosova, ndërsa vlera e përgjithshme e këtij projekti do të jetë 100 mijë euro, ku gjysmën e projektit do ta financoj komuna, ndërsa gjysmën tjetër Caritas-i.

“Kjo marrëveshje, parasheh përmirësimin e shërbimit shëndetësor shtëpiak dhe ambulator, për familjet me anëtar të sëmurë dhe të moshuar, të cilët kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore permanente në Komunën e Malishevës dhe zonave rurale” thuhet mes tjerash në marrëveshjen e nënshkruar.

Sipas marrëveshjes, ky projekt, po ashtu parasheh rritjen e standardit të jetesës, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve mjekësore në familjet e tyre dhe ngritjen e nivelit të kujdesit shëndetësor dhe ambulator, duke angazhuar staf mjekësor në kuadër të QKMF-së në Malishevë.

Implementues i këtij projekti është Caritas Kosova, që në bashkëpunim me komunën, do të menaxhojnë dhe do të përcjellin nga afër realizimin e projektit.

Inspektorët në aksion për mallra me afat të skaduar

Malishevë, 26 dhjetor

Nga fillimi i kësaj jave, e deri në fund të këtij viti, inspektorët komunal, janë në aksion, duke bërë kontrollimin e subjekteve afariste, për kontrollimin e produkteve ushqimore për afat të skaduar, bën të ditur Drejtoria Komunale e Inspektoratit.

Sipas drejtorit, Ismet Kafexholli, “kontrolli është duke u kryer në të gjitha subjektet afariste që kanë mallra ushqimore, ndërsa shitja e këtyre mallrave, për shkak të festave të fundit, është më e madhe”. “Në ato subjekte afariste te cilat hasim mall me afat të skaduar, malli i skaduar ju konfiskohet dhe asgjësohet dhe njëkohësisht lënda do tu dërgohet në gjykatën kompetente për dënim nga gjykata”, thuhet në njoftimin e drejtorisë.

Aksioni do të zgjatë deri në fund të ditëve festive.

Me këtë rast, Drejtoria e Inspektoratit, “Ju bën thirrje të gjithë qytetarëve, që nëse eventualisht, hasin në ndonjë subjekt afarist, me ndonjë mall me afat të skaduar, të lajmërojnë Drejtorinë e Inspektoratit në KK të Malishevës, në mënyrë, që pastaj ti marrim masat e mëtutjeshme”.

Kryetari Kilaj, mbajti takimin e dytë publik me qytetarë

Malishevë, 27 dhjetor



Kryetari i Malishevës, Z.Isni Kilaj, sot ka mbajtur takimin e dytë publik me qytetarët e Komunës së Malishevës, të cilët i ka njoftuar me punët dhe aktivitetet vjetore gjatë vitit 2012, si dhe me prioritetet e qeverisë komunale, për vitin 2013, përderisa është përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe interesimet e qytetarëve, që lidhen me punën e qeverisë komunale.

“Viti 2012 ka qenë një vit i suksesshëm, ku janë realizuar shumë projekte, të cilat lidhen drejtpërdrejt me jetë dhe mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha mes tjerash kryetari Kilaj, i cili më pas i njoftoi të pranishmit me projektet e realizuara gjatë vitit 2012.

“Gjatë këtij viti kemi realizuar një varg projektesh, duka filluar nga ndërtimi i objektit të shkollës në Carrallukë, përfundimi i ndërtimit të Palestrës Sportive, Stadiumit të qytetit, hapja e Shpellës së Flladit në Panorc, zgjerimi i rrugës Malishevë-Banjë, Muzeu i qytetit, asfaltime të rrugëve në disa fshatra të Malishevës, zgjerimi i rrugës “Rilindja Kombëtare” në Malishevë, pastaj ujësjellës për disa fshatra, funksionalizimi i ujësjellësit në Maxharrë, rritja e kapaciteteve për ujësjellësin në Malishevë dhe në Carrallukë, vazhdimi i fazës së tretë për ndërtimin e kolektorit kryesor të ujërave të zeza, ndihma për fermerët-përkatësisht në blegtori, faza e parë e ndërtimit të shkollës në Vermicë, pastaj ndihma për 36 familje të pastreha nga ana e Komunës, si dhe pesë të tjera nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kanalizime në shumicën dërmuese të fshatrave” tha Kilaj, duke përmendur 23 projekte kapitale të realizuara gjatë vitit 2012.

“Pavarësisht investimeve, infrastruktura, gjithmonë do të mbetet sfidë për çdo qeveri që vjen në pushtet, për shkak të rritjes së nevojave të qytetarëve”, tha Kilaj, duke premtuar vazhdimin e investimeve në fushën e infrastrukturës, edhe në vitin 2013.

Në vazhdim të debatit, qytetarët, kryesisht kanë prezantuar nevojën për investime në fushën e infrastrukturës, përderisa, kanë kërkuar edhe mirëmbajtje më të mirë të rrugëve, gjatë stinës së dimrit, për çka edhe kryetari Kilaj, pranoi se ndoshta, është e vetmja fushë, ku ka dështuar, pasi sipas tij “200 kilometra rrugë, është vështirë të mirëmbahen gjatë reshjeve të mëdha të borës”,

por siguroi se të gjitha rrugët, do të jenë të qarkullueshme dhe do të bëhet maksimumi i mundshëm nga ana e komunës, për hapjen e rrugëve, nëse ka të reshura të mëdha të borës.

Në fund të debatit, kryetari Kilaj, prezantoi edhe prioritetet për vitin 2013, ku u paraqitën afro 40 prioritetet, për vitin 2013, disa prej tyre të bartura nga viti 2012, si projekte dyvjeçare, duke filluar me bashkëfinancim me qytetarët, rreth 200 mijë euro, pastaj, ujësjellësi për fshatin Drenoc, vazhdimi i ndërtimit të Muzeut të Qytetit, vazhdimi i ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza, kanalizimet për fshatrat Astrazup, Bubavec, Bellanicë, Banjë, Plloqicë dhe disa fshatra dhe lagje tjera, pastaj, asfaltimi i rrugëve në Kijevë, Bubavec, Balincë, pjesa e tretë, zgjerime të rrugëve Malishevë-Banjë dhe asfaltime tjera në fshatrat e Malishevës, rehabilitimi i ujësjellësit në Kijevë, financim në bujqësi, ndërtimi i shkollës në Shkozë, meremetimi komplet i shkollës në Bellanicë, ndërtimi i shkollës në Vërmicë (vazhdimi), pastaj ndërtimi i shkollës në Damanek, renovimi i një shkolle në Drenoc, ndërtimi i fushave sportive nëpër shkollat e Komunës së Malishevës, blerja e aparaturave në QKMF, vazhdimi i spërkatjeve selektive kundër rriqrave, ndërtimi i trotuareve në Malishevë dhe vendbanime tjera, ndërtimi i akumulacionit afër Shpellës së Flladit në Panorc dhe shumë projekte tjera.

Asambleja vendosi që veteranët e luftës të lirohen nga taksat

Malishevë, 28 dhjetor



Këshilltarët e Asamblesë Komunale të Malishevës, sot kanë marrë vendim, që të gjithë veteranët e luftës së UÇK-së, të lirohen nga taksat komunale, për shërbimet administrative. Ky vendim, është marrë në mbledhjen e sotme të Asamblesë Komunale, me ç'rast janë miratuar dy rregullore, si dhe janë miratuar dy raporte të punës së Drejtorisë Komunale për Arsim dhe Edukim.

Paraprakisht, në mbledhjen e sotme, këshilltarëve të KK të Malishevës, ju është

drejtuar Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, i cili përveç një prezantimi të shkurtër për punën njëvjeçare të ekzekutivit, i ka falënderuar këshilltarët komunal, për punën e bërë në këtë vit. “Ju falënderoj dhe ju shpreh mirënjohjen time, për punën e bërë, pa të cilën as ekzekutivi, nuk do të



kishte mundur ti realizonte objektivat e saj”, tha mes tjerash Kilaj. “Gjatë vitit kemi realizuar një varg projektesh, në të mirë të qytetarëve të Komunës së Malishevës, projekte të cilat, kanë një qëndrueshmëri dhe të cilat, për gjenerata të tëra nuk kanë nevojë të brengosen brezat e ardhshme”.

Asambleja Komunale, ka miratuar rregulloren për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoba Komunale, për vitin 2013, rregullore në të cilën, edhe kanë marrë vendim për lirim nga taksat administrative për veteranët e UÇK-së, përderisa ka miratuar edhe rregulloren për përdorimin e gjuhëve në Komunën e Malishevës.

Në mbledhjen e fundit, Asambleja Komunale e Malishevës, ka miratuar edhe dy raporte të Drejtorisë Komunale për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2011/2012 dhe atë për fillimin e vitit shkollor 2012/2013.

Përgatitur nga Zyra për Informim Publik